



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 85/2012
Prishtinë, më 21.11.2012, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala, Hashim Dëshishku dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Hakif Jashari, Luan Morina dhe Bedri Dragusha –MZHE; Ukë Gashi-ZPRK; Burim Ejupi – INDEP; Flamur Hyseni- NDI dhe Florije Mehmeti- KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit dhe Teuta Sahatqija-zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12 dhe 14.11.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për efikasitetin e energjisë;
4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë, lidhur emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së);
5. Të ndryshme.

Në fillimin, mbledhjen e kryesoi zëvendëskryetarija e parë e Komisionit, Teuta Sahatqija, në mungesë të kryetarit, e cila konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – Propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, si pika e pestë (5):

-Shqyrtimi i rekomandimit, lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12 dhe 14.11.2012

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12 dhe 14.11.2012 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë

Kryesuesja – Tha se grupi i punës, pas disa aktiviteteve që i ka zhvilluar gjatë monitorimit, e ka hartuar Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë. Pastaj fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, Visar Ymerit, për ta paraqitur raportin.

Visar Ymeri – Tha se grupi i punës gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për eficiencën energjisë, aktivitetet i ka zhvilluar në bazë të Planit të veprimit, i cili është hartuar nga grupi i punës. Ai theksoi se gjatë monitorimit ka pasur dy takime: një me kryeshefin e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë - AKEE, drejtorin e Departamentit të Energjisë dhe Minierave, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si dhe një takim me përfaqësuesen nga Zyra e BE- së në Kosovë. Po ashtu ka realizuar dy vizita, një në shkollën fillore “Shkolla e Gjelbër” në Prishtinë dhe në Komuna e Shtimes. Gjatë këtyre takimeve dhe vizitave, ne jemi informuar për së afërmi se me cilat pengesa dhe probleme hasin gjatë zbatimit të ligjit. Po ashtu, kemi organizuar dëgjim publik me të gjitha palët, që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe që merren me këtë sektor. Ai falënderoi përfaqësuesin e OJQ-së INDEP, që gjatë gjithë kohës ka ndihmuar me ekspertizë grupin e punës. Pastaj prezantoi si në vijim:

Rekomandime

- 1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në Strategjinë Legjislative për vitin 2013, plotësim- ndryshimin e Ligjit për eficiencën e energjisë.*
- 2. Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në afatin prej tre (3) muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve.*
- 3. Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të ndajë buxhet të mjaftueshëm për financim dhe bashkëfinancim të projekteve, me aplikim të masave eficiente dhe të jetë më efektive në përfitimin e fondeve publike nga institucionet e jashtme për investime në fushën e eficiencës së energjisë. Po ashtu, Ministria të ketë prioritet ngritjen e kapaciteteve administrative të Agjencisë së Kosovës për Eficiencën e Energjisë.*
- 4. Agjencia e Kosovës për Eficiencën e Energjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duhet të ndërmarrin fushata vetëdijesuese mbi rëndësinë e eficiencës së energjisë me karakter afatgjatë, në mënyrë që të shtohen aktivitetet në fushën e edukimit dhe vetëdijesimit.*

5. *Komunat të hartojnë planet e tyre komunale për eficiencën e energjisë, në mënyrë që të jenë më konkurruese në përfitim të fondeve të jashtme, të destinuara për eficiencën e energjisë, në afatin prej gjashtë (6) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.*
6. *Të thellohet bashkëpunimi në mes të Agjencisë së Kosovës për Eficiencën e Energjisë dhe komunave.*

Dhe, Rekomandimin shtesë që:

- *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, raportin për eficiencën e energjisë, që e harton për Qeverinë, t'ia dorëzojë me shkrim Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.*

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë.

4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë, lidhur emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së)

Kryesuesja – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës e kemi një propozimvendim të Qeverisë, lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së). Pastaj e hapi debatin për ta shqyrtuar këtë Propozimvendim.

Sala Berisha – Shala - Tha se është mirë që e kemi për shqyrtim këtë Propozimvendim të Qeverisë, lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së. Pasi që Bordi i AKP-së është i pakompletuar dhe pa mandat prej korrikut të vitit 2012, kemi vakum institucional. I mbështeti të propozuarit për këtë Bord dhe kërkoi që në bazë të procedurave të futet në seancën plenare për shqyrtim, që është e paraparë të mbahet më 22.11.2012, pasi që është çështje imediate për marrjen e vendimeve të rëndësishme, që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit.

Visar Ymeri - Në këtë listë, të cilën e ka sjellë Qeveria për emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së, kemi shumë pak informacion në CV-të e të propozuarve për anëtarë, me përjashtim për z. Blerim Rexha. Ndërsa, për këta të tjerët nuk kemi shumë informacione as në CV-të e tyre. Prandaj, ai tha se është edhe një arsye shtesë pse do të votojë kundër këtyre emërimeve dhe shtoi se është kundër që të futet në seancën e së nesërme me urgjencë.

Myzejene Selmani – Pajtohet me znj. Berisha – Shala për përshpejtimin e miratimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së. Për shkak të mosemërimit të anëtarëve të Bordit të AKP-së deri më tani, në këtë Agjenci kanë mbetur shumë vendime të rëndësishme pa u miratuar, në mungesë të Bordit të AKP-së. Ajo kërkoi nga Administrata e Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria që para procedimit në seancë plenare, të plotësohen CV-të, sepse janë të mangëta, madje disa vetëm në gjuhën angleze ose vetëm në gjuhën shqipe.

Lutfi Zharku - Tha se në parim është për emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së, por nuk është e arsyeshme që të përshpejtohet procedura për futjen në rendin e ditës për seancën plenare që pritet të mbahet nesër, më 22.11.2012. Dhe, procedimin më të shpejtë mund ta bëjnë grupet parlamentare e jo Komisioni. Po ashtu, ai tha se nëse Komisioni duhet vetëm t'i procedojmë tutje, ndërsa Kuvendi le të vendosë për apo kundër.

Kryetari - Pajtohet që Kuvendi të vendosë se a të votohen për apo kundër, por është çështje procedurale që ne si Komision FunkSIONAL duhet të japim një rekomandim se a do ta përkrahim këtë Propozimvendim të Qeverisë apo jo.

Pas debatit, Komisioni me shumicë votash nxori këtë

R e k o m a n d i m

Kuvendi të miratojë Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/98, datë 29.10.2012, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të propozuarit si në vijim:

- Blerim Rexha, kryesues;
- Maja Milanoviç, anëtare;
- Haxhi Arifi, anëtar;
- Dardane Peja, anëtare dhe
- Skënder Komoni, anëtar.

5. Shqyrtimi i Rekomandimeve, lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetari - Tha se pas një takimi që kishim me të gjithë përfaqësuesit e agjencive dhe rregullatorëve që i raportojnë Komisionit, lidhur me Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë për buxhetin dhe projektet buxhetore, në fund të mbledhjes jemi pajtuar që t'i hartojmë disa rekomandime në bazë të kërkesave të agjencive dhe rregullatorëve. Stafi mbështetës i Komisionit i ka nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes kërkesat dhe i ka hartuar në formë të rekomandimeve.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

R e k o m a n d i m

Komisioni i përhershëm për Buxhet dhe Financa, të aprovojë kërkesat e agjencive dhe rregullatorëve të pavarur si në vijim:

- Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM, t'i aprovohet kërkesa për staf profesional (inspektor të xehetarisë) dhe për blerjen e pajisjeve për konfiskim;
- Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës – AKK, t'i aprovohet kërkesa apo t'i shtohet zë buxhetor për shpalljen e interesit të objektit me qira;
- Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave – ARH, t'i aprovohet kërkesa për staf të nevojshëm profesional.

6. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit